



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. _____ Prot.

Patos, më ___/___/2024

MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

DETYRË PROJEKTIMI

Objekti: “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të Bllokut të Vreshtit, Lagjja e Re”

Vendndodhja: Lagjja e Re, Patos

Investitori: Bashkia Patos

Gjendja e Objektivit

Objekti që kërkohet të investohet ndodhet në “Lagjen e Re”, në pjesën jug- perëndimore të qytetit të Patosit dhe përfshin degëzime të rrugëve në vazhdim të rrugës së Vreshtit. Gjatësia totale e rrugëve është 2350 m. Rrugët janë pjesërisht të shtruara me rërë bituminoze e stabilizant ku në shumë vende janë dëmtuar përgjate viteve.

Gjendja aktuale e këtyre rrugëve është në kushte jo të mira për arsye se në këtë segment nuk janë bërë ndërhyrje të mirefillta, duke u bërë shkak për amortizimin e vazhdueshëm deri në gjendjen në të cilën ndodhet sot. Qarkullimi i mjeteve automobilistike për në pjesën tjetër të qytetit është i vështirë. Gjithashtu edhe fëmijët që frekuentojnë shkollat në pjesën e qytetit, përveç largësisë kanë edhe vështirësinë e kalimit në një rrugë me mungesë totale infrastrukture.

Problematikë për këtë segment rrugor mbetet edhe mungesa e kanalizimeve të ujrave të bardha dhe të zeza, mungesa e trotuareve dhe ndricimi rrugor. Kanalizimet e ujrave të bardha mungojnë plotësisht, me përjashtim të një kanali anësor në segmentin e Vreshtit, i ndërtuar nga vetë banorët ndërsa për ujrat e zeza, segmente të caktuara janë të pajisura me rrjet kanalizimi ndërsa të tjerat kanë nevojë për ndërtim rrjeti të ri. Po ashtu ndricimi rrugor mungon plotësisht, ç’ka e bën të rrezikshëm qarkullimin e këmbësorëve dhe automjeteve gjatë natës.

Në këto kushte ky segment është problematik për banorët dhe automjetet që qarkullojnë dhe konsiderohet e domosdoshme ndërhyrja në rikonstrukcionin, sistemimin dhe përmisimin e qarkullimit në zonë.

Qëllimi i Projektit:

- Rehabilitimi i rrugëve të këtij Blloku, sistemimi i ujrave sipërfaqësore të shiut, ujrave të zeza, ndërtim të trotuareve dhe ndricimi rrugor.
- Krijimi i kushteve të sigurta për lëvizjen e banorëve në këtë segment rrugor dhe përmirësimi i jetesës për banorët e këtij Blloku.

Objektivat e realizimit të këtij projekti janë

- Ndërtim i paketës së re të shtresave të rrugëve dhe krijimi i kushteve sa më të sigurta për banorët e zonës.
- Krijimi i aksesit për lëvizjen e kembësorëve dhe automjeteve.
- Sistemimi i ujrave të bardha dhe atyre të zeza
- Ndërtimi i mureve mbajtëse për sigurimin e qëndrueshmërisë së rrugës në segmente të caktuara.

Detyrat që duhet të zgjidhë projekti:

1. Gërmim dhe skarifikim të shtresës sipërfaqësore ekzistuese të rrugës
2. Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të ujrave të bardha dhe atyre të zeza, sistemimi dhe lidhja me rrjetin ekzistues.
3. Ndërtim të trupit të ri të rrugës me paktën e rë të shtresave asfaltike
4. Ndërtim sipërfaqe trotuari
5. Ndërtimi i mureve mbajtëse me b/a për garantimin e qëndrueshmërisë së rrugës;
6. Preventivi të bëhet me çmimet manuale në fuqi dhe duke u shoqëruar me analizat për zërat e punimeve që nuk janë parashikuar në manualët e miratuara.

Konceptoi: Gazmira Plesati

Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Ermenita Mici
